

Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË

DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 9068/prot  
3

Vlorë, 20.12.2023

PROJEKT - VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ .2023

“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT PËRFUNDIMTAR TË BUXHETIT  
AFATMESËM 2024-2026”

Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_ .2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë Vlorë, mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni pika 2, neni 9 pika 1. lb të Kreut III, neni 34 pika 6, neni 41 pika 1, neni 64 pika c të Kreut X, i ndryshuar: Ligjin Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 33, 34, 35, 36, 37. Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet e bëra. Udhëzimi plotësues Nr.2 datë 19.01.2023 "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2023", Udhëzimin Nr.9 datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit" si dhe Udhëzimi plotësues Nr.6 datë 28.02.2023 "Për Përgatitjen e Programit Afatmesëm Vendor 2024-2026"

VENDOSI:


1. Të miratojë programin përfundimtar për programin buxhetor afatmesëm 2024-2026, sipas dokumentit bashkëlidhur këti projekt vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

KRYETAR

Ermal Dredha







**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT**

**RELACION**  
**MBI PROGRAMIN PËRFUNDIMTAR TË BUXHETIT AFATMESËM 2024-2026**

Të nderuar këshilltarë,

Sikurse jeni në dijeni me VKB nr. 60, datë 31.07.2023 “Mbi projekt vendimin për miratimin e projekt dokumentit të parë për programin buxhetor afatmesëm 2024-2026” është miratuar buxheti afatmesëm 2024-2026.

Bazuar në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Qeverisjes Vendore”, pika 82, si dhe në Udhëzime plotësuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 Administrata e Bashkisë Vlorë ka vijuar me procedurat përkatëse sipas afateve të përcaktuara.

Në funksion të kësaj procedure është miratuar kalendari për programin buxhetor është hartuar programi buxhetor, i cili është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë e cila ka dërguar Rekomandimet përkatëse.

Mbi bazën e këtyre Rekomandimeve janë bërë plotësimet përkatëse dhe programi është miratuar në Këshillin e Bashkisë. Këshilli i Bashkisë gjithashtu ka miratuar tavanet përfundimtarë të Programit Buxhetor Afatmesëm. Sipas procedurës së parashikuar në udhëzimet e sipërcituara mbi bazën e Programit Buxhetor Afatmesëm të miratuar si dhe të taveve përfundimtare të miratuar gjithashtu nga Këshilli i Bashkisë përgatitet Programi Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar, pasi bëhet edhe konsultimi me publikun dhe grupet e interesit. Administrata e bashkisë sikurse jeni në dijeni gjatë mujit tetor ka realizuar dëgjuesat publike sipas Rajoneve dhe Njësive Administrative në gjithë territorin e bashkisë.

Paraprakisht theksojmë që në hartimin e programit Buxhetor Afatmesëm të miratuar tashmë tavanet e të ardhurave dhe të shpenzimeve, të cilat kanë qenë bazë për projekt buxhetin e vitit 2024 Administrata e Bashkisë Vlorë është bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor 2017-2030, i cili është një dokument bazë dhe strategjik, si dhe Planin Strategjik të Zhvillimit.

Fushat prioritare janë turizmi si një katalizator i rritjes ekonomike, zhvillimi ekonomik, punësimi, zhvillimi komunitetit, transporti dhe mbrojtja e mjedisit. Prioritet kyç ekonomike të identifikuar nga Plani i Zhvillimit të Vlorës janë: përmirësimi i konkurrueshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik, zhvillimi i zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekoomi të qëndrueshme, nxitja e sipërmarrjes dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor, përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shërbimeve për popullsinë rezidenciale dhe rritja e kohezionit social. Njëkohësisht në këtë Program Buxhetor Afatmesëm rëndësi e vecantë i është kushtuar edhe krijimit të infrastrukturës së domosdoshme në Arsimin Parashkollor, si dhe në Arsimin 9-Vjeçar.



Treguesit kryesor të materilizuar në këtë Program Buxhetor përsa i përket tavaneve përfundimtare për të ardhurat dhe shpenzimet janë bazuar në mesataren e tre vitetve të fundit buxhetore dhe në treguesit vjetor të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Këshilli Bashkiak Vlorë në buxhetin vjetor të vitit 2023.

Konkretisht transferta e pakushtëzuar për vitin 2023 është 674,396 mijë lekë dhe mbi bazë e këtij planifikimi parashikojmë për vitet 2024-2026 një rritje prej 6% ose 710,738 mijë për vitin 2024, 748,811 mijë për vitin 2025 dhe 788,025 mijë për vitin 2026.

**Sqarojmë se me hartimin e buxhetit 2024 treguesi i transfertës të pakushtëzuar është në masën 798,527 mijë lekë, element i ndryshuar në PBA e vitit 2024-2026.**

Transferta specifike për vitin 2023 është planifikuar 447,453 mijë lekë, për vitin 2024 parashikohet në po të njëjtën vlerë, për vitin 2025 është planifikuar 474,297 mijë lekë dhe për vitin 2026 ,502,754 mijë lekë sipas Udhëzimit nr.6, datë 28.02.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”.

**Sqarojmë se me hartimin e buxhetit 2024 treguesi i transfertës specifike është në masën 485,785 mijë lekë, element i ndryshuar në PBA e vitit 2024-2026.**

Përsa i përket të ardhurave te veta në këtë Programi Buxhetor Afatmesëm për vitet 2024-2026, si dhe në Planin Buxhetor të vitit 2024 nuk janë parashikuar rritje të konsiderueshme pasi jemi bazur në realizimin faktik të tyre në vitet e mëparshme. Kjo me qëllim që planifikimi i të ardhurave të jetë real, për rrjedhojë projektet e parashikuara, si dhe shërbimet për komunitetin të mbulohen realisht me fonde financiare, për të mos krijuar detyrime të pashlyera në vitet respektive. Edhe shpenzimet në vlerë në tërësi dhe sipas programeve janë parashikuar në të njëjtat nivele sikurse dhe investimet. Në këtë drejtim, jemi bazuar në shërbimet që ofron aktualisht bashkia, si organ i qeverisjes vendore.

Sipas këtij arsytimi nëse u referohemi të ardhurave nga të ardhurat e veta taksa e tarifave vendore në programin buxhetor afatmesëm 2024 – 2026 në raport me vitin 2023 ka një rritje të lehtë progresive . Sipas viteve për vitin 2024 parashikohet rritje 9%, për vitin 2025 11% dhe për vitin 2026 një rritje prej 12%. Kjo rritje për vitet 2024-2026 parashikohet të jetë në taksën e pasurisë së paluajtshme, në taksën e ndikimit në infrastrukturë, tarifa për zënie të hapsirave publike, tarifa për menaxhimin e mbetjeve, per gjelbërimin etj. Konkretisht të ardhurat nga të ardhurat e veta janë parashikuar: Viti 2024, 1,501,312 mijë lekë, viti 2025 1,528,957 mijë lekë dhe viti 2026 1,563,138 mijë lekë.

**Sqarojmë se niveli i të ardhurave të veta për vitin 2024, të planifikuara në projekt buxhetin e vitit 2024, ka ndryshuar dhe është në vlerën 1.893.272 mijë leke. Ky ndryshim në zërin e të ardhurave ka ardhur si rezultat i ndryshimit të disa taksave dhe tarifave vendore.**

Me sa parashtrua me lart, të ardhurat në total për buxhetin e Bashkisë Vlorë sipas këtij Programi Buxhetor Afatmesëm sipas viteve janë:

Viti 2024 3,177,584 mijë lekë, viti 2025 2,752,065 mijë lekë, viti 2026 2,853,917 mijë lekë.

Përsa u përket investimeve për vitin 2024 parashikohen 377,748 mijë lekë, për vitin 2025 parashikohen 411,272 mijë lekë dhe për vitin 2026 427,955 mijë lekë.



**Sqarojmë se ndryshimi në zërin e investimeve për vitin 2024 sipas projekt buxhetit të vitit 2024 është rritur në vlerën 248,609 mijë lekë, pra në total 626,357 mijë lekë.**

Referuar të dhënave të mësipërme sqarojmë se projekt vendimi që ju paraqitet për miratimin përfundimtar të PBA-së 2024-2026, grupi i punës ka marrë në konsideratë dëgjuesat publike të realizuara gjatë muajit tetor, grantin e pakushtëzuar dhe specifike të akorduara nga qeveria shqiptare, nivelin e taksave dhe tarifave të ndryshuara si dhe projekt buxhetin e hartuar për vitin 2024.

Përsa është paraqitur në dokumentin bashkëlidhur, kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij projekt vendimi.

Ju faleminderit,


**KRYETAR**

**Ermal Dredha**









**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORE**

**Programi Buxhetor Afatmesëm**  
**2024 - 2026**

<b>1. HYRJE .....</b>	<b>4</b>
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR .....	4
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË .....	6
<b>2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË VLORE .....</b>	<b>7</b>
2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE.....	7
2.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË VLORE .....	8
<b>3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË VLORE.....</b>	<b>8</b>
3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË.....	9
3.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJA E PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRFITUESIT .....	9
<b>4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË VLORE 2024-2026 .....</b>	<b>9</b>
4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË VLORE NË VITET 2024-2026.....	11
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Vlorë për vitet 2024-2026 .....	11
4.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Vlorë për periudhën 2024-2026.....	15
4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR .....	16
<b>5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE.....</b>	<b>18</b>
011: ORGANET EKZEKUTIVE DHE LEGJISLATIVE, ÇËSHTJET FINANCIARE DHE FISKALE, ÇËSHTJET E BRENDSHME .....	19
PLANIFIKIMI MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI.....	19
032: MBROJTJA NGA ZIARRI DHE MBROJTJA CIVILE.....	20
042: MENAXHIMI I UJITJES DHE KULLIMIT.....	21
045: RRJETI RRUGOR RURAL .....	22
051: MENAXHIMI I MBETJEVE.....	23
052: FURNIZIMI ME UJE DHE KANALIZIME.....	26
062: SHERBIMET PUBLIKE VENDORE .....	27
081: SPORT DHE ARGËTIM .....	28
082: TRASHËGIMIA KULTURORE, MONUMENTET, MUZETË DHE BIBLIOTEKAT .....	29
091: ARSIMI BAZË DHE PARASHKOLLOR .....	30
092: ARSIMI I MESËM .....	29
101: PËRKUJDESI SOCIAL .....	31

*Lista e Shkurtimeve*

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MFE	– Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto

- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arrijtjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njëzia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

## 1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart<sup>4</sup> i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.6 datë 28.02.2023 “Për Përgatitjen e Programit Afatmesëm Vendor 2024-2026”, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2024-2026 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanet e përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT) dhe Formatet e reja për planifikimin e shpenzimeve të programit.

Referuar parashikimeve në udhëzimet e cituara me lartë Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë është përmbyllur me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili është miratuar nga Këshilli i bashkisë dhe përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i

<sup>4</sup> Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për “Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”

PBA-së është bërë publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe është dërguar në MFE, brenda datës 1 qershor e cila ka përgatitur dhe dërguar bashkisë komentet dhe rekomandimet përkatëse. Në funksion të kësaj faze nga Bashkia Vlorë me vendimin nr.97 datë 30.12.2022 është miratuar kalendari për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, me urdhërin e brendshëm të kryetarit të Bashkisë nr.15 datë 23.01.2023 është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe ekipet e menaxhimit të programeve, me vendimin nr.22 datë 31.03.2023 të Këshillit të Bashkisë janë miratuar tavanet përgatitor të të ardhurave për PBA dhe me vendimin nr.23 datë 31.03.2023 janë miratuar tavanet përgatitor për PBA 2024-2026 lidhur me shpenzimet sipas programeve buxhetor.

Në vijim të procedurave të miratimit të PBA-se me shkresën nr, 6461 dt, 01.06.2023 dokumenti fillestar i PBA-së i është dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për vlerësim.Ndërkohë Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr,11099 dt, 19.06 2023 ka dërguar në Bashkinë Vlore opinionin e saj nëpërmjet komenteve për problematika të caktuara të cilat janë marrë parasysh nga Administrata e Bashkisë dhe janë reflektuar në këtë projekt dokument te PBA-së.Në vijim nga Administrata e Bashkisë por edhe me pjesmarrjen e Anëtarëve të Këshillit të Bashkisë janë organizuar edhe dëgjesa publike në Njësitë Administrative ,në Rajonet dhe Lagjet e Bashkisë si dhe me grupet e interesit.Propozimet dhe vërejtjet e bëra kryesisht lidhur me taksat,tarifat si dhe projektet e investimeve për vitin 2024 por edhe në plan afat mesëm gjithashtu përgjithësisht janë reflektuar në këtë Program Buxhetor Afatmesëm dhe veçanërisht në buxhetin e vitit 2024 që është dhe viti i parë i Programit Buxhetor Afatmesëm 2024/2026 përfundimtar.

## 2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë Vlorë

Me një shtirje gjeografike të gjerë, Bashkia Vlorë është një nga zonat me karakteristikat dhe të larmishme në Republikën e Shqipërisë. Kjo larmi shfaqet si në terrenin e saj dhe karakteristikat gjeografike ashtu edhe në larmishmërinë kulturore dhe demografike. Rrallë qytete në botë mund të kenë një pozicion kaq të volitshëm gjeostrategjik siç e ka Vlora, e cila lidhet me daljen e saj të menjëherëshme në det dhe mbështetjen në vargmalet në lindje.

Gjiri i Vlorës dallohet për resurset e shumta natyrore, për biodiversitetin e pasur dhe koridoret ekologjike. Është ndër zonat me potencialin turistik më të lartë të vendit, gjë që lidhet me daljen direkte në det, me pasuritë e shumtanatyrore, klimaterike, ujore, arkeolo-gjike, historike, kulturore, njerëzore dhe ekonomike.

Me një fokus kryesisht në turizem dhe agro-turizëm, Bashkia Vlorë pret një numër të konsiderueshëm të turistëve të huaj dhe vendas. Sipas të dhënave të INSTAT dhe agjensive të ndryshme zona e Rivierës Shqipëtare pret numrin më të madh të turistëve të huaj kryesisht nga Polonia, Gjermania, dhe vendet skandinave. Prandaj edhe fokusi i investimeve përqëndrohet kryesisht në facilitimin e turizmit dhe në të njëjtën kohë ruajtjen e burimeve natyrore.

Bashkia Vlorë ka në përbërjen e saj,Qytetin Vlorë si dhe 4 Njësi Administrative të cilat janë: Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë. Planit të Përgjithëshëm Vendor i Vlorës është promovimi i zhvillimit dhe turizmit të qëndrueshëm në zonë, i cili adreson nevojën për të mbrojtur burimet e vlefshme dhe për të promovuar menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke minimizuar ndikimet negative në mjedis të zhvillimit lokal dhe të infrastrukturës.

### 2.1 Situata e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore

Zona bregdetare në juridiksion të Bashkisë Vlorë, në një shtirje prej disa kilometrash përbën pjesën më të madhe dhe më tërheqëse të Rivierës Shqipëtare, është një rast unik i njësisë territoriale me karakteristika

të dallueshme, në të cilën aktualisht janë duke u zbatuar disa projekte të rëndësishëm në infrastrukturë dhe që janë në studim projekte të tjera zhvillimi në lidhje me zhvillimin e saj të ardhshëm. Pavarësisht se cilësia e rrugëve në vitet e fundit është përmirësuar ndjeshëm vecanerisht përfundimi i Bajpasit të Vlorës e ka lehtësuar trafikun mbetet akoma për të bërë për rrugët në fshatra dhe sistemimin e territorit në Lagjet e Qytetit. Sfidë mbetet gjithashtu menaxhimi i mbetjeve urbane vecanerisht në periudhen e sezonit turistik ku për shkak të shumfishimit të popullsisë nga ardhja e turistëve rritet intensiteti i mbetjeve në njësia kohës.

## 2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikën e Bashkisë Vlorë

Hartimi i objektivave mundëson realizimin e një plani që garanton një zhvillim të qëndrueshëm. Ecuria e procesit paralelisht me etapat e hartimit të Planit siguron një bashkëpunim frytdhënës midis këtyre instrumentave në drejtim të ruajtjes së parametrevë mjedisore të zonës në studim si dhe atyre të shëndetit publik. Këto objektivat janë hartuar në përputhje me ligjshmërinë kombëtare dhe ndërkombëtare duke mbajtur parasysh direktivat evropiane, konventat ndërkombëtare dhe dokumenta të tjera të rëndësishëm. Ligjet shqiptare dhe direktivat e ndryshme evropiane lidhur nga njëra anë me tokën, biodiversitetin, pyjet, ujën e pijshëm, detin, lumenjtë, liqenet, rezervuarët dhe nga ana tjetër ato për shëndetin publik kanë shërbyer si orientuese në hartimin e këtyre objektivave.

Ndër objektivat më të rëndësishëm mund të përmendim;

Për shtrirjen gjeografike lidhur me terrenin, afërsinë me detin, dhe malin njëkohësisht që ka Vlorë, gjithë projektet e zhvillimit vecanerisht në infrastrukturë në kulturë, në art, por edhe në promovim kanë si objektiv të parë ta kthejnë Vlorën si një pikë referimi për zhvillimin e turizmit.

- Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, i zonave dhe llojeve të mbrojtura, si dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe mjedisit në përputhje me angazhimet evropiane dhe ndërkombëtare.
- Sigurimi i ujit të pijshëm për të gjithë popullatën; Mbrojtja e të gjithë burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës me qëllimin për ta bërë më pjellore, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja.
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve aq sa të reduktohen rreziqet për shëndetin publik, mjedisin, dhe tregtinë në përputhje me kërkesat e BE.
- Zhvillim urban të qëndrueshëm dhe planifikim i përdorimit të tokës.
- Sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik me përqëndrim në agro-turizëm, bujqësi dhe mbështetje të ekonomisë rurale.

## 3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë Vlorë

Bashkia do të jetë aktor kryesor në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të zones me kompetenca dhe instrumente konkrete që nxisin sipërmarrjen dhe investimet. Klima lokale e biznesit do të mbështetet me nisma konkrete dhe investime publike që lehtësojnë thithjen e investimeve nga biznesi. Promovimi dhe nxitja e klimës së biznesit do të jetë synim i vecantë i Bashkisë Vlorë. Duke qënë se këtë vit fillon një

mandat i ri për organet drejtuese të Qeverisjes Vendore do të rishikohen plani strategjik i zhvillimit, si dhe planet territoriale në funksion të objektivave dhe strategjise së zhvillimit të bashkisë nga organet e reja drejtuese.

### 3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

Ky program konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe të menaxhimit të Bashkisë vlorë. Ai siguron mbështetjen në burime financiare, materiale dhe njerëzore të Aparatit të Bashkisë për realizimin e detyrave dhe objektivave që u janë ngarkuar në përputhje me objektivat e vendosura në planin strategjik të zhvillimit. Qëllimet dhe objektivat e politikës së këtij programi konsistojnë në :Sigurimin e burimeve financiare, menaxhimin sa më efektiv të burimeve financiare e njerëzore, rritjen e aftësive funksionale në të gjitha nivelet

Ofrimi i shërbimeve të plota, cilësore dhe në një kohë të shkurtër për biznesin dhe qytetarët. Nxitja e qytetarëve, biznesit dhe palëve të interesuara për tu bërë pjesë e planifikimit të buxhetit. Krijimin e një administrate profesionale, të aftë të përballojë sfidat gjithëpërfshirëse të integritetit. Përmirësimin e menaxhimit dhe përdorimit me efikasitet të fondeve. Administrim me efikasitet dhe efektivitet të sistemit tatimor. Transparencë, informim dhe asistencë ligjore për të gjithë tatimpaguesit. Nxitja e qytetarëve, biznesit dhe palëve të interesuara për tu bërë pjesë e planifikimit të buxhetit

### 3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsye dhe Përfituesit

Analiza e gjendjes ekzistuese së situatës gjatë studimeve të ndryshme ka trajtuar këto çështje kyçe dhe problematika që duhet të adresohen: 1. Problemet socio-ekonomike si rezultat lëvizjeve demografike që kërkojnë domosdoshmërisht investimeve për përmirësimin e infrastrukturës për ta përshtatur edhe me ndërtimet informale të legalizuara. 2. Kjo për të eliminuar pasojat që rrjedhin nga zhvillimi sporadik dhe i shpërndarë që çon në përdorim të paqëndrueshëm të tokës dhe urbanizimit. 3. Mangësi në shërbimet publike vecanërisht, menaxhimi i mbetjeve urbane por edhe infrastruktura në brëndësi të Lagjeve të Qytetit dhe në fshatra. 4. Keqpërdorimi i resurseve natyrore dhe tokës si asj truell në qytet edhe asj buqëore. 5. Sistem i papërshtatshëm i vendgroposjeve dhe largimit të mbeturinave të ngurta. 6. Guroret dhe aktivitetet industriale. 7. Ndotja akustike vecanërisht gjatë sezonit turistik. 8. Përkeqësimi i cilësisë së ajrit. 9. Mungesa e ndërgjegjësimit mjedisor të bizneseve, popullsisë dhe vizitorëve. 10. zgjidhja e problematikave që shoqërojnë administrimin e bashkëpronësise në ndërtesat e banimit e tej

## 4. BUXHETI AFATMESEM I BASHKISË VLORE 2024-2026

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Vlorë gjatë periudhës 2024-2026, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2024-2026, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2024-2026. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia.

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

Tabela 1. Të dhëna mbi Bashkinë Vlorë

Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë						
	Të Pergjithshme	2019	2020	2021	2022	2023
Numri i Njësive Administrative	5.0					
Numri i Fshatrave	37.0					
Sipërfaqja e Bashkisë (km <sup>2</sup> )	617.0					
Qyteti	17.0					
Njësitë Administrative	600.0					
Sipërfaqja e Bashkisë (km <sup>2</sup> )	-					
Zonë Urbane	-					
Tokë Bujqësore	-					
Kullota	-					
Pyje	-					
Popullsia e Bashkisë		200,574.0	201,834.0	202,791.0	204,500.0	205,000.0
Qyteti		142,876.0	143,932.0	144,744.0	146,000.0	146,500.0
Njësitë Administrative		57,698.0	57,902.0	58,047.0	58,500.0	59,000.0
Mosha Mesatare e Popullsisë		40.0	40.0	40.0	40.0	40.0
Numri i Lindjeve		606.0	661.0	643.0	215.0	500.0
Numri i Vdekjeve		659.0	691.0	819.0	540.0	250.0
Numri i Bizneseve Aktive		4,703.0	5,155.0	5,260.0	5,324.0	5,500.0
Numri i Familjeve		46,370.0	47,627.0	48,751.0	49,000.0	50,000.0
Qyteti		159,996.0	16,408.0	16,733.0	17,000.0	17,500.0
Njësitë Administrative		955.0	955.0	1,006.0	1,001.0	1,005.0
Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Plotë		955.0	955.0	955.0	1,006.0	1,282.0
Administrata e Bashkisë		146.0	276.0	297.0	297.0	280.0
Njësitë Shpenzuese		609.0	679.0	709.0	704.0	1,002.0
Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Pjesëshme		-	-	-	-	-
Administrata e Bashkisë		-	-	-	-	-
Njësitë Shpenzuese		-	-	-	-	-
Numri i Programeve Buxhetore		35.0	35.0	35.0	35.0	20.0



### 4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Vlorë në vitet 2024-2026

#### 4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Vlorë për vitet 2024-2026

A	TË ARDHURA NGA BËRIMET E VETA	2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Parashikimi sipas Buxhetit	Parashikimi Pritshëm	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
<b>A.1</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE</b>	436,894	449,672	672,196	476,172	868,283	847,368	850,368
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	12,137	12,137	-	-	-	0	0
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e përkohshme	217,192	219,777	301,355	226,017	290,318	285,818	297,318
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	191,418	192,756	250,198	187,649	236,954	236,954	236,954
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	13,562	14,819	38,739	29,054	38,739	38,739	38,739
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	12,212	12,202	12,418	9,314	14,625	19,625	21,625
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	-	-	-	-	-	-	-
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	14,915	19,033	20,635	21,000	27,224	27,224	27,224
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturën nga ndërtimet e reja	180,941	180,941	336,186	220,640	529,717	502,802	502,802
A.1.5	Taksa e tabelës	11,709	17,784	14,020	10,515	21,024	22,024	23,024
A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe lotaritë vendore	-	-	-	-	-	-	-
A.1.7	Taksa e përkohshme	-	-	-	-	-	-	-
A.1.8	Taksa e përkohshme 1	-	-	-	-	-	-	-
A.1.9	Taksa e përkohshme 2	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.2</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA (GRANTE)</b>	130,513	130,513	129,800	89,175	148,374	65,751	65,751
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të ardhurave në mbeturitë / pasuritë e përkohshme	27,905	27,905	31,000	23,250	23,000	23,000	23,000
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	70,475	70,475	83,400	62,550	87,800	5,177	5,177
A.2.3	Taksa e rontës minierare	-	-	-	-	0	0	0
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	32,133	32,133	15,000	3,375	37,574	37,574	37,574
A.2.5	Taksa të tjera	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.3</b>	<b>TË ARDHURA NGA TARIFA VENDORE</b>	300,564	327,397	414,589	330,044	803,344	840,751	580,800
A.3.1	Tarifa me menashtim të mbeturjeve	186,280	205,113	256,917	192,688	298,035	261,741	268,177
A.3.1.1	Tarifa e pasurimit për familjet	100,280	104,961	109,688	109,688	132,593	152,447	156,453
A.3.1.2	Tarifa e pasurimit për institucionet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.1.3	Tarifa e pasurimit për biznesin	86,000	103,152	106,946	83,000	165,442	109,294	111,724
A.3.2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbeturjeve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.3	Tarifa për ndërtimin publik	-	-	-	-	0	0	0
A.3.3.1	Tarifa për ndërtimin publik nga familjet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.3.2	Tarifa për ndërtimin publik nga institucionet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.3.3	Tarifa për ndërtimin publik nga bizneset	-	-	-	-	-	-	-
A.3.4	Tarifa për gjelbërimin	-	-	-	-	0	0	0
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga institucionet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	94,218	94,218	114,475	88,993	174,633	230,508	242,711
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	10,968	10,968	5,033	4,932	5,033	2,502	2,502
A.3.5.2	Tarifa për dhënie e llogaritave, lejeve e autorizimeve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	220	220	-	-	-	-	-
A.3.5.4	Tarifa për vlerësimin e veprimit të shërbimeve të tjera	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.5	Tarifa e pasurimit të veprimtarive të transportit	5,693	5,693	11,173	10,726	11,173	5,832	5,832
A.3.5.6	Tarifa e pasurimit për mjediet e krijuara dhe vëndparkime publike	2,038	2,038	2,856	2,713	5,177	1,900	1,900
A.3.5.7	Tarifa për dhënie llogare e për trashëgiminë në ftesë bruto dhe në produkte të saj	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.8	Tarifa për pyjet dhe kulltat	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtetëse nga tjerë / bashkia	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.10	Tarifa për zënim dhe përdorimin e hapësirës publike dhe faradave	75,299	75,299	95,413	70,622	150,250	220,274	232,477
A.3.5.11	Tarifa për trashëgimi dhe shërbime të tjera në fardhë	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.12	Tarifa për linjat e tjera dhe ndërtimore (Telefoni, Energj, TV, Kabllor, Internet)	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për lehtar, ankand etj	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	12,407	12,407	23,802	22,968	25,693	23,497	23,497
A.3.6.1	Biblioteka	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.2	Muzeumet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.3	Teatri	351	351	550	550	790	550	550
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	659	659	1,775	1,775	1,875	1,526	1,526
A.3.6.5	Pallati i sportit	-	-	691	651	755	595	595
A.3.6.6	Qendra Komunitare	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.7	Mensa (Konvikti)	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.8	Kopshtet	10,297	10,297	18,200	17,472	19,647	18,200	18,200
A.3.6.9	Çerdhet	1,100	1,100	2,626	2,520	2,626	2,626	2,626
A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	-	-	-	-	-	-	-
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ulljes dhe kullimit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.9	Tarifa e përkohshme	-	-	3,983	3,983	3,983	3,983	3,983
A.3.10	Tarifa të tjera	7,659	7,659	15,412	21,412	4,000	21,022	22,522
<b>A.4</b>	<b>TË ARDHURAT E TJERA</b>	109,793	92,926	221,700	193,476	373,271	323,649	333,649
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	1,730	1,730	41,325	41,325	41,325	41,703	41,703
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	-	-	-	-	-	-	-
A.4.3	Fkimi nga ndërmarrjet publike në varësi të bashkisë	-	-	-	-	-	-	-
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat	-	-	-	-	-	-	-
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	-	-	300	288	-	-	-
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	-	-	-	-	-	-	-
A.4.7	Kundërvalet administrative (Gjohat)	100,077	83,210	112,850	84,638	258,946	208,946	218,946
A.4.8	Sekustrime dhe Zhdëmtime	-	-	-	-	-	-	-
A.4.9	Kuotat e anëtarësive të bashkive	-	-	-	-	-	-	-
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	-	-	-	-	-
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	-	-	-	-	-	-	-
A.4.12	Shitja e aseteve financiare	-	-	-	-	-	-	-
A.4.13	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	-	-	-	-	-	-	-
A.4.14	Të tjera	7,986	7,986	67,225	67,225	73,000	73,000	73,000
<b>B</b>	<b>TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR</b>	960,681	894,524	1,121,849	1,121,849	1,284,312	1,284,312	1,284,312
<b>B.1</b>	<b>Trasferta e pakushtëzuar</b>	548,229	565,117	674,396	674,396	798,526	798,526	798,526
<b>B.2</b>	<b>Trasferta e kushtëzuar</b>	412,452	429,407	447,453	447,453	485,786	485,786	485,786
B.2.1	Për funksionet e deleguara	412,452	429,407	447,453	447,453	485,786	485,786	485,786
B.2.2	Për projekte të veçanta	-	-	-	-	-	-	-
<b>B.3</b>	<b>Trasferta specifike</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>C</b>	<b>HUAMARRJA</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>C.1</b>	<b>Huamarrja afatshkurtë</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>C.2</b>	<b>Huamarrja afatgjatë</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>D</b>	<b>TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR</b>	304,141	463,016	846,886	846,886	-	-	-
<b>D.1</b>	<b>Trashëgimi pa destinacion</b>	137,194	363,473	535,916	535,916	-	-	-
<b>D.2</b>	<b>Trashëgimi me destinacion</b>	67,147	100,143	310,970	310,970	-	-	-
	<b>TOTALI I TË ARDHURAVE (A+B+C+D)</b>	<b>2,142,786</b>	<b>2,453,648</b>	<b>3,406,620</b>	<b>3,059,602</b>	<b>3,177,584</b>	<b>3,061,831</b>	<b>3,094,970</b>

Referuar tabelës më lartë nënseksioni i mëposhtëm paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme. Te ardhurat e vitit 2023 rezultojnë në vlerë më të lartë për arsye se shumës së planifikuar në buxhetin fillestar i janë shtuar fondet e trashëguara nga viti 2022. Nderkohë shumës së planifikuar në vitin 2024 e në vijim është më e lartë se shumës fillestare e planifikuar në 2023.

### Te ardhurat e Bashkisë Vlorë

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

Gjate vitit fiskal 2023 nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore kemi 6190 subjekte të regjistruara. Duke parë ecurinë ekonomike të viteve të fundit si dhe parashikimit të investimeve, parashikojmë që numri i subjekteve për periudhën 2024 – 2026 do të ketë rritje si më poshtë:

NR	Bashkia Vlore	Subjekte	Subjekte	Subjekt e	Subjekt e	Subjekte	Subjekte	Subjekte
		2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
1	TP sh. pakice	2,782	2,766	2,787	2,161	2,226	2,293	2,362
2	TP sh. shumice	207	206	43	39	40	41	42
3	TP sherbim	910	899	1,454	2,318	2,388	2,400	2,490
4	TP p.lira	314	364	358	310	319	329	339
5	TP BM ad.kryesore	551	601	747	809	833	858	884
6	TP BM ad.dytesore	496	488	355	278	286	295	304
7	T.P prodhim			198	229	236	243	250
8	OJF			38	46	47	48	49
	<b>TOTALI</b>	<b>5,260</b>	<b>5,324</b>	<b>5,880</b>	<b>6,190</b>	<b>6,376</b>	<b>6,507</b>	<b>6,720</b>

### Të ardhurat nga Menaxhimi i Pasurive Publike

Të ardhurat nga menaxhimi i pasurive publike përfshijnë të ardhurat e gjeneruara nga dhënia me qira e tokës bujqësore, pronës, tokës dhe pajisjeve palëve të treta.

Kësaj takse i nënshtrohen të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregjet publike në administrim të Bashkisë Vlorë.

Baza e kësaj takse është sipërfaqja në m<sup>2</sup> për tregtimin e artikujve të ndryshëm dhe kjo takse llogaritet si detyrim ditor ose mujor.

## Tarifa për zënien e hapësirës publike përbëhet prej:

Nr	Emertimi	Tarifa leke/m2 ne muaj	Siperfaqja m2	Totali
1	Per zenien e hapësirave publike ne Bulevardin Vlore Skele (duke perfshire te dyja anet e tortuarit), pedonalia e sheshit Pavaresia Skele ( ne te dyja anet)			
	Per perdorimin e hapësires publike sipas akt kontrolleve te terrenit	500	418	1,280,400
	Per perdorimin e hapësires publike per 12 muaj	400	4124.5	19,797,600
2	Per zenien e hapësirave publike ne zonen e Lungomares			
	Per perdorimin e hapësires publike per 12 muaj	400	6654	31,939,200
	Per perdorimin e hapësires publike sipas akt kontrolleve te terrenit	600	3179.32	9,183,400
3	Per zenien e hapësirave publike ne zonen e Qendres Historike			
	Per perdorimin e hapësires publike per 12 muaj	300	265	954,000
	Per perdorimin e hapësires publike sipas akt kontrolleve te terrenit	400	539.5	1,297,312
4	Per zenien e hapësirave publike ne zonen e Plazhit te Vjeter dhe rruga Transballkanike (te dy anet e saj)			
	Per perdorimin e hapësires publike per 12 muaj	300	501	1,803,600

	Per perdorimin e hapësirës publike sipas akt kontrolleve te terrenit	400	570	1,087,000
4	Per zenien e hapësirave publike per zonat e tjera pervec pikes 1,2 dhe 3	200	5121	10,686,424
5	Subjektet tregëtarë që ushtrojnë veprimtari në tregjet publike të miratuara dhe tregëtarët ambulant	50/100		1,583,545
<b>Total</b>				<b>79,612,481</b>

Element vleresimi per planifikim eshte shuma 79,612 mijë lekë.

Nr	Per zenien e hapësirës publike per plazh	Tarifa leke/sezon	siperfaqe m2	Vlera per vitin 2024
1	Zver nec, Plazhi Vjeter	500	56,583	28,291,500
2	Lungomare	650	17,190	11,173,500
3	Fushat e Sportit deri ne Pashaliman Orikum	750	41,564	31,173,000
		<b>TOTALI</b>	115,337	<b>70,638,000</b>

*Totali për elemnt vlerësimi të hapësirës publike është vlera 150.250 mijë lekë.*

Në planifikimin e të ardhurave burim i rëndësishëm vlerësohen taksa e ndikimit në infrastrukturë, shfrytëzimi i stacioneve të plazhit treguesit e të cilave bazohen kryesisht në realizimet e viteve të mëparëshme dhe vecanërisht ato të vitit 2023.

#### 4.1.1.4 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së. Kjo transfertë është parashikuar sipas shkresës nr. 20079 prot, datë 03.11.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për periudhën 2024 – 2026. Gjithashtu edhe trasferta e pakushtëzuar e përgjithëshme është dërguar Bashkise nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për vitet 2024- 2026 në shumat respektive të paraqitura si më poshtë.

Vitet	2023	2024	2025	2026
Tranf. e Pakusht	674,396	798,526	748,811	788,025

## 4.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Vlorë për periudhën 2024-2026

Më poshtë paraqiten shpenzimet aktuale, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve gjatë periudhës 2021 deri në 2026.

PBA 2024-2026								
(E1) SHPENZIMET E PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK								
BASHKIA								
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
Emërtimi i Llogarisë	Kodi	Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga & Sigurime		760,469.0	843,519.0	1,167,806.0	1,110,042.0	1,456,631.0	1,214,998.0	1,249,157.0
Pagat	600	657,467.0	723,526.0	1,001,085.0	951,194.0	1,255,846.0	1,041,447.0	1,070,396.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	103,002.0	119,993.0	166,721.0	158,848.0	200,785.0	173,551.0	178,761.0
Shpenzime Korente		671,029.0	852,993.0	1,159,597.0	1,093,507.0	1,094,596.0	1,039,080.0	1,090,706.0
Mallra dhe Shërbime	602	591,120.0	811,479.0	1,130,354.0	1,066,010.0	946,486.0	989,280.0	1,019,382.0
Subvencioni	603	45,560.0	4,365.0	0.0	0.0	30,900.0	15,000.0	35,700.0
Transfertë e Brendshme	604	32,901.0	8,403.0	9,950.0	9,452.0	18,933.0	12,200.0	12,300.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Tjera (606, 651, etc.)	606	1,448.0	28,746.0	19,293.0	18,045.0	98,277.0	22,600.0	23,324.0
Shpenzime Kapitale		222,349.0	150,897.0	1,016,962.0	957,733.0	626,357.0	411,272.0	427,955.0
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	222,349.0	150,897.0	1,016,962.0	957,733.0	626,357.0	411,272.0	427,955.0
<b>Totali</b>		<b>1,653,847.0</b>	<b>1,847,409.0</b>	<b>3,344,365.0</b>	<b>3,161,282.0</b>	<b>3,177,584.0</b>	<b>2,665,350.0</b>	<b>2,767,818.0</b>

## 4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR

Nr.	EMERTIMI	Vlera totale e propozuar	Vlera parashikuar ne vitin 2023	Vlera e kerkuar per vitin 2024
<b>Investime te parashikuara ne njesite administrative</b>				
1	Rikonstruksioni i rruges se Fshatit Radhime	36,597,501	6,000,000	30,597,501
2	Rikonstruksioni i shkolles Hasan Pulo, Orikum	3,596,030		3,596,030
3	Rruga e varrezave ne fshatin Cerkovine	6,128,179		6,128,179
4	Rruga Petro Llambro ne fshatin Skrofotine	7,389,667	4,500,000	2,889,667
6	Rikonstruksioni i rruges se fshatit Drithas	17,609,994	8,000,000	9,609,994
7	Rikonstruksioni i rruges se shkolles ne Fshatin Babice e Madhe	15,720,669		15,720,669
	<b>SHUMA I</b>	<b>87,042,040</b>		<b>68,542,040</b>
<b>Investime te parashikuara ne Bashkine Vlore</b>				
1	Rikonstruksioni i tualeteve te shkolles "Ismail Qemali" (2202608), "15 Tetori" (3324661) dhe kopshtit Nr. 5 (1551603)	7,078,872		7,078,872
2	Rikonstruksion dhe shtesë anësore 3 kate ne shkollën -vjeçare "Lef Sallata"	191,634,733	87,780,000	103,854,733
